



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20402 Prot.

Lezhë, më 27 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 103, Datë 26. 11. 2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR NDËRTIMIN E
QENDRËS DITORE TË MOSHËS SË TRETË NË LEZHË

Në mbështetje nenit 8 dhe 24, të Ligjit Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" neni 6/1 shkronja "dh", Ligji Nr. 7892, datë 21.12.1994, për "Sponsorizimet", i ndryshuar, Neni 761, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar Vendim të Keshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj", pas shqyrtimit të relacionit , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

- 1- Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimët e Ballkanit" për Ndërtimin e Qendrës Ditore të Moshës së Tretë në Lezhë bashkëngjitur këtij vendimi.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. 18297 Prot.

Lezhe, më 21. 10 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

BASHKISE LEZHE

DHE

SHOQATËS BAMIRËSE "JETIMËT E BALLKANIT"

PËR BASHKËPUNIMIN NË NDERTIMIN E QENDRES DITORE PER
MOSHEN E TRETE NE LEZHE

PALET KONTRAKTORE

PËRFITUESI
BASHKIA LEZHE
KRYETARI
PJERIN NDREU



DHURUESI
SHOQATA BAMIRËSE "JETIMËT E BALLKANIT"
PERFAQESUESI
HALIL KASTRATI

Bezat Kabaku

Bkab



Sot, në datën ___/___/2025, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet Bashkise Lezhe, perfaqesuar nga Kryetari Z. Pjerin Ndreu dhe shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit”, regjistruar në Regjistrin e Organizatave Joqeveritare në Republikën e Kosovës, me nr. regjistrimi 5112584-3, datë 23.10.2009, me numër fiskal 600322200, perfaqesuar nga z. Halil Kastrati, referuar më poshtë si “Donatori”, të cilëve bashkërisht iu referohet si “Palët” dhe secilit prej tyre si “Pala”.

Duke qenë se:

A. Në Lezhe mungon nje qender ditore ne sherbim te moshes se trete dhe shtresave ne nevoje me qellim permiresimin e jetes dhe ofrimin e sherbimeve sa me bashkohore si dhe duke qene se Bashkia Lezhe ne permbushje te detyrimeve ligjore per ofrimin e sherbimeve per moshen e trete angazhohet te ofroje truallin per ndertimin e ketij objekti.

B. Ligji nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.6, shkronja “a” dhe neni 64, shkronjat “a” dhe “gj”, parashikon se:

Neni 9 “Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë: a) të drejtën e lidhjes së kontratës”,

Neni 64 “Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës; gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”,

C. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” neni 6/1 shkronja “dh” parashikon se: *“Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror I. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore: dh) të moshuarit në nevojë”,*

D. Vendim te Keshillit e Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”, parashikon se:

“Njësitë e qeverisjes vendore.

Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njësisve të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për: - krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, - ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, - krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel vendor kanë përgjegjësi për planifikimin, administrimin dhe ofrimin e asistencës sociale dhe shërbimeve sociale në nivel lokal. Njësitë

e vlerësimit dhe referimit të nevojave (NJVRN), njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), koordinatorët lokal përgjegjës për dhunën në familje dhe ndaj grave dhe punonjës të tjerë të shërbimeve sociale janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore si dhe krijimin e shërbimeve dhe tipologjive të ndryshme të shërbimit për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme në kontekstin lokal. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të

Dhe:

-Duke u mbështetur në nenin 761, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon. Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi",

-Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 7892, datë 21.12.1994, për "Sponsorizimet", i ndryshuar.

-Meqenese mungon një qender ditore për moshën e tretë dhe për shtresat në nevojë si dhe duke qenë se ka shprehur vullnetin shoqata bamirëse "Jetimët e Ballkanit" për të ofruar donacionin për ndërtimin e një qendre multifunksionale në Lezhë,

palët bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj marrëveshje është dhurimi pa kundershperblim i kryerjes së investimit deri në 2,000,000 (dy milion) euro për realizimin e punimeve për ndërtimin e "Kuzhines Humanitare dhe Qendres Ditore për moshën e tretë" nga Shoqata Bamirëse "Jetimët e Ballkanit", në favor të Bashkisë Lezhë në truallin me nr. Pasurie 6/41, në Zonën Kadastrale 8632.

Neni 2

Masa e donacionit

2.1 Masa e donacionit të Shoqatës Bamirëse "Jetimët e Ballkanit", sipas kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është në vlerën deri në 2,000,000 (dy milion) Euro të Kostos së objektit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

3.1. Dhuruesi (shoqata bamirëse "Jetimët e Ballkanit"), merr përsipër:

- a) Të financojë me fondet e tij, kundrejt asnjë detyrimi monetar nga ana e Bashkisë Lezhë, projektimin dhe kryerjen e punimeve për ndërtimin e qendres ditore për moshën e tretë, deri në vlerën 2,000,000 (dy milion) Euro.

- i) Bashkia Lezhe merr persiper realizimin e mobilimit te brendshem te ketij objekti ne nje vlere pre 30,000,000 (tridhjete milion) Lek, pas ndertimit dhe ne perfundim te punimeve nga donatori dhe marrjes ne dorezim te objektit, si dhe merr persiper shpenzimet operative per menaxhimin e qendres ku perfshihen paga per staf, uje, energji, etj te cilat do te percaktohen ne planin e menaxhimit te qendres nga Drejtoria e Sherbimit dhe Kujdesit Social prane Bashkise Lezhe.
- j) Menaxhimi i kuzhines humanitare brenda objektit te qendres per te moshuar do te behet nga shoqata Bamirëse "Jetimët e Ballkanit", me stafin e saj dhe per kete qellim Bashkia obligohet ti jape ne perdorim dy zyra (ambiente) ne kete objekt per veprimtarin e saj dhe rrjedhimisht shoqata do te menaxhoj pjeserisht qendren, respektivisht kuzhinen dhe dy zyra per nje afat prej 30 (tridhjete) viteve.
- k) Bashkia Lezhe nepermjet Drejtorise se Sherbimit dhe Kujdesit Social dhe Drejtorise se Finances dhe Buxhetit do te marre te gjitha masat per angazhimin buxhetor te vleres prej 30,000,000 (tridhjete milion) Lek ne vitin 2027.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

4.1 Çdo njoftim që do t'i jepet një Palë dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim. Çdo ndryshim i adresës së njëres Palë do të duhet t'i njoftohet me shkrim Palës tjetër.

Neni 5

Ndryshimet

5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

Neni 7

Konfidencialiteti

7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëratjetrën, në lidhje me realizimin e Projektit, do t'i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t'i transferojnë ato te një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo Marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi pas miratimit nga Keshilli i Bashkise Lezhe dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

8.2 Me miratimin e kesaj marreveshje Keshilli i Bashkise Lezhe shpreh dakordesine per perdorimin e pasurise me nr. 6/41, ne Zonen Kadastrale 8632 per qellimin sipas objektit te kesaj marreveshje dhe shpreh dakortesin per marrjen e angazhimeve buxhetore dhe angazhimeve te tjera sipas kesaj marreveshje si dhe i jep autorizim Kryetarit te Bashkise per nenshkrimin e te gjitha akteve ne favor te realizimit te investimit nga shoqata bamirëse "Jetimët e Ballkanit", ne pasurine me nr. 6/41, ne Zonen Kadastrale 8632.

Neni 9

Përfundimi i Marrëveshjes

9.1 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
- shkelën dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- për forcë madhore.

9.2 Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

9.3 Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj kontrate.


10.2 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë mes palëve. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj kontrate bëhet vetëm në formë të shkruar.

10.3 Kjo kontratë hartohet në 5 kopje, nga ku 1 (nje) kopje origjinale për shoqaten bamirëse "Jetimët e Ballkanit" dhe 4 (kater) kopje per Bashkine Lezhe, të cilat pasi bien dakord e nënshkruajnë atë rregullisht.


Kushtet e mësipërme aprovohen dhe firmosen në emër të palëve kontraktuese:

PALET KONTRAKTORE

PËRFITUESI
BASHKIA LEZHE
KRYETARI
PJERIN NDREU



DHURUESI
SHOQATA BAMIRËSE "JETIMËT E BALLKANIT"
PERFAQESUESI
HALIL KASTRATI



Nr. 20402/1 prot

Dt: 04.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1167/6 Prot.

Lezhë, më 03.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për prefektin e qarkut" i ndryshuar, nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", nenin 761 të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM-në nr. 152, datë 13.3.2024 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.103, datë 26.11.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për ndërtimin e Qendres Ditore të Moshës së Tretë në Lezhë".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

